

Sveçlës i refuzohet vizita në Luginë të Preshevës

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (19) ■ FAQE 4-5

PRESIONET NDAJ DELEGACIONIT TË KOSOVËS DHE SPEKULIMET RRETH KONFERENCËS SË RAMBUJESË



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së nëntëmbëdhjetë, ka folur për presionet ndaj delegacionit të Kosovës dhe spekulimet rreth

Konferencës së Rambujesë. Ai ka treguar se gjatë dy javëve të para në Rambuje delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë punuan tërësisht të ndarë njëri nga tjetri dhe komunikimi zhvillohej nëpërmjet ndërmjetësuesve të bashkësisë ndërkombëtare. Bardhyl Mahmuti,

gjithashtu, ka folur për projekt marrëveshjen që duhej ta nënshkruanin të dyja delegacionet më 20 shkurt 1999 dhe 'kërcënimin' që morën delegacionet nga kështjella e Rambujesë në rast se dështon kjo marrëveshje

SEKRETARI I JASHTËM BRITANIK, DAVID CAMERON, KA QËNDRUAR PËR VIZITË NJËDITORE NË KOSOVË

CAMERONI RITHEKSON PËRKRAHJEN E BRITANISË PËR SOVRANITETIN E KOSOVËS DHE SJELLJEN E NJOHJEVE TË REJA



Sekretari i Jashtëm britanik, David Cameron, ka thënë të enjten në Prishtinë se Britania është mbështetëse e madhe e pavarësisë, sovranitetit dhe do të ndihmojë në sjelljen e njohjeve të reja për Kosovën. Ish-kryeministër i Britanisë gjatë takimit me presidenten

Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe ministren e Jashtme, Donika Gërvalla, ka theksuar se shteti i tij do ta ndihmojë Kosovën në rrafshin e sigurisë, atë të zhvillimit ekonomik, të qeverisjes dhe në të gjitha çështjet me të cilat përballlet aktualisht

OPINION

INDIFERENCA NDAJ GJYKATËS SPECIALE F.9

Shkruan:
Sali BISLIMI



AKTUALE



RITJJA E RASTEVE ME COVID RIKTHEN BARTJEN E MASKAVE NË DISA SPITALE NË SHBA F.2

MURTEZAJ: NJOHJET NGA PESËSHJA E BE-SË, SFIDA PËR KOSOVËN NË VITIN 2024 F.7

EKONOMI



LIBERALIZIMI I VIZAVE, MË SË SHUMTI DO TË PËSOJË SEKTORI PRIVAT F.8

LIROHET NGA DETYRA DREJTORI TEKNIK NË KRU "PRISHTINA", SOKOL XHAFA F.8

SPORT



KAMPIONIA BOTËRORE FABIANA BYTYQI MBRON TITULLIN MË 13 JANAR F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rritja e rasteve me Covid rikthen bartjen e maskave në disa spitale në ShBA

UASHINGTON, 4 JANAR - Spitalet në të paktën katër shtete të ShBA-së kanë rikthyer detyrimin për bartjen e maskave pas rritjes së rasteve me Covid, gripit sezonal dhe sëmundjeve të tjera të frymëmarrjes, raporton agjencia e lajmeve "Reuters".

Objektet e kujdesit shëndetësor në Nju-Jork, Kaliforni, Illinois dhe Masaçusets e kanë bërë të detyrueshme bartjen e maskave për pacientët dhe ofruesit e shërbimeve shëndetësore.

Komisionari për Shëndet i qytetit të Nju-Jorkut, dr. Ashwin Vasan, i tha WABC TV-së të mërkurën se bartja e detyrueshme e maskave ka rifilluar në të 11 spitalet publike të qytetit, 30 qendra shëndetësore dhe pesë objekte të kujdesit afatgjatë. "Ajo që nuk duam është mungesa e personelit, apo jo? Kur pamë valën e Omicron-it më 2022, problemet më të mëdha nuk ishin vetëm njerëzit që sëmureshin, por që kishim shumë punonjës shëndetësorë të vijës së parë, ata ishin jashtë me Covid-19", tha Vasan për WABC-në.

Të dhënat më të fundit javore nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) treguan se kishte mbi 29 000 hospitalizime nga Covidi në të gjithë ShBA-në nga 17 deri më 23 dhjetor, ose 16 për qind më shumë në krahasim me javën paraprake.

Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve gjithashtu raportuan më shumë se 14 700 raste hospitalizimi për shkak të gripit në të njëjtën periudhë.

Bartja e detyrueshme e maskave ishte pika e ndezur politike dhe kulturore gjatë pandemisë me Covid-19, duke shkaktuar zemërim në mesin e atyre që ndoqën këshillat mjekësore dhe vërejtën se maskat bënë pak për ta parandaluar përhapjen e sëmundjes.

Një Gjykatë e Lartë e dominuar nga konservatorët hodhi poshtë detyrimin federal të presidentit Joe Biden për vaksinë ose testim të detyrueshëm për kompanitë dhe një gjyqtar i emëruar nga paraardhësi i tij republikan hodhi



poshtë detyrimin për bartjen e maskës në transport publik. Kishte, gjithashtu, pakënaqësi të thellë midis atyre që bartnin maska dhe mendonin se shëndeti i tyre ishte vënë në rrezik nga ata që nuk bartnin maska. Më shumë se 1.1 milion

amerikanë kanë vdekur nga Covid-19, tregojnë shifrat e CDC-së, një normë më e madhe se shumica e vendeve të tjera të pasura. Sistemi mjekësor i Universitetit Rush në Çikago tha të martën se kërkoi që "pacientët, vizitorët dhe

stafi të bartnin maska - kërkesa për bartjen e maskave në disa zona të kompleksit u miratua nga spitali". Ato përfshijnë zonat e pritjes klinike dhe regjistrimin e pacientëve.

Cook County Health, i cili përfshin Çikagon dhe Endeavour Health në periferi të Çikagos, muajin e kaluar filloi të kërkonte përsëri maska pasi Departamenti i Shëndetit Publik të Illinoisit u kërkoi spitaleve t'i rrisin përpjekjet parandaluese në disa fusha, duke përfshirë përdorimin e maskës në të gjithë objektin.

Në Masaçusets, Berkshire Health Systems filloi me bartjen e detyrueshme të maskave të mërkurën, sipas një deklaratë.

Në Kaliforni, Qarku i Los Anxhelosit, të shtunën rivendosi bartjen e maskave në të gjitha objektet e licencuara të kujdesit shëndetësor, sipas një deklaratë të qarkut dhënë Shërbimit të Lajmeve të Qytetit. Departamenti i Shëndetësisë nuk ka dhënë ndonjë koment lidhur me këtë çështje.

Ukraina thotë se mbrojtja e saj ajrore mund t'i përballojë edhe "disa sulme të tjera"



KIEV, 4 JANAR - Mbrojtja ajrore lëvizëse e Kievit ka municion të mjaftueshëm për t'u përballur me disa sulme më të fuqishme, por më pas do të ketë nevojë për më shumë ndihmë perëndimore, tha më 3 janar Serhiy Naye, komandanti i forcave të përbashkëta të ushtrisë së Ukrainës.

Në fund të vitit të kaluar, Rusia nisi sulmet e saj më të mëdha me raketa dhe dronë që nga fillimi i pushtimit në shkurt 2022.

Më pas bombardoi kryeqytetin dhe qytetin e dytë më të madh të

Ukrainës, Kharkiv, më 2 janar, duke vrarë pesë persona dhe duke plagosur dhjetëra. Ushtria ukrainase tha se Rusia e sulmoi me 90 dronë gjatë natës, duke cilësuar si "numër rekord" të sulmeve ajrore. "Ka municion të mjaftueshëm për t'u bërë ballë disa sulmeve të ardhshme të fuqishme", tha Naye për agjencinë e lajmeve AFP, derisa përmendi situatën aktuale me sistemet e mbrojtjes ajrore lëvizëse.

Në fund të vitit të kaluar Organizata e Kombeve të Bashkuara i kërkoi Rusisë t'i

ndalojë "menjëherë" sulmet në Ukrainë.

Komisionari i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Volker Turk, dënoi më 29 dhjetor valën vdekjeprurëse të sulmeve ruse në të gjithë Ukrainën dhe i kërkoi Moskës t'i ndërprejë sulmet. "E drejta ndërkombëtare humanitare ndalon në mënyrë eksplicite sulmet e qëllimshme ndaj objekteve civile dhe, sulmet pa dallim, në çdo rrethanë", tha ai.

Rusia e ka filluar pushtimin e plotë dhe të paprovokuar të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Bideni do ta nisë vitin duke bërë fushatë në mbrojtje të demokracisë

UASHINGTON, 4 JANAR - Presidenti i Amerikës, Joe Biden, do ta nisë vitin duke bërë fushatë në vende me rëndësi historike ku do të përkujtojnë ngjarje të rënda, duke përfshirë trevjetorin e sulmit vdekjeprurës ndaj Kapitolit. Ai, gjithashtu, do ta vizitojë një kishë në Karolinën e Jugut, ku një amerikan i bardhë i armatosur vrau besimtarët afrikanë-amerikanë.

Gjatë këtyre vizitave ai pritët të argumentojë se zgjedhjet presidenciale që do të mbahen

këtë vit mund ta përcaktojnë fatin e demokracisë amerikane. Të shtunën presidenti Biden do të shkojë në një zonë të Pensilvanisë, Valley Forge, ku George Uashingtoni dhe Ushtria Kontinentale kaluan një dimër të zymtë gati 250 vjet më parë.

Atje ai do ta dënojë rolin e ish-presidentit Donald Trump për t'i nxitur mbështetësit e tij që sulmuan Kongresin amerikan në një përpjekje për t'i përmbysur zgjedhjet presidenciale të vitit 2020.

Dy ditë më vonë presidenti do ta vizitojë kishën "Mother Emanuel" në Charleston ku nëntë persona janë vrarë me armë zjarri në qershorin e vitit 2015 nga një supremacist i bardhë.

Gjatë këtyre dy vizitave ai do ta karakterizojë paraardhësin e tij si një kërcënim serioz për parimet mbi të cilat u themelua vendi, duke argumentuar se Trumpi do ta minojë demokracinë amerikane nëse fiton një mandat të dytë.



SEKRETARI I JASHTËM BRITANIK, DAVID CAMERON, KA QËNDRUAR PËR VIZITË NJËDITORE NË KOSOVË

Cameroni rithekson përkrahjen e Britanisë për sovranitetin e Kosovës dhe sjelljen e njohjeve të reja

Sekretari i Jashtëm britanik, David Cameron, ka thënë të enjten në Prishtinë se Britania është mbështetëse e madhe e pavarësisë, sovranitetit dhe do të ndihmojë në sjelljen e njohjeve të reja për Kosovën. Ish-kryeministër i Britanisë gjatë takimit me presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe ministren e Jashtme, Donika Gërvalla, ka theksuar se shteti i tij do ta ndihmojë Kosovën në rrafshin e sigurisë, atë të zhvillimit ekonomik, të qeverisjes dhe në të gjitha çështjet me të cilat përballet aktualisht

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 JANAR - Sekretari i Jashtëm britanik, David Cameron, ka thënë të enjten në Prishtinë se Britania e Madhe do ta ndihmojë Kosovën në aspiratat e saj duke përmendur këtu procesin e njohjeve të reja. Gjatë një deklarimi për medie me ministren e Punëve të Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla, Cameroni ka theksuar rëndësinë e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, duke thënë se Britania e Madhe po investon për to. "Ne jetojmë në një botë me

Cameroni ka thënë tutje se me ministren Gërvalla diskutuan për sigurinë, rritjen ekonomike, luftën kundër korrupsionit dhe ndërtimin e shtetit, duke theksuar se Mbretëria e Bashkuar është mbështetëse e madhe e pavarësisë, sovranitetit dhe do të ndihmojë në sjelljen e njohjeve të reja për Kosovën. Gjatë këtij takimi ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e ka njoftuar kryediplomatën britanik rreth progresit dhe zhvillimit të jashtëzakonshëm të Kosovës në fusha të ndryshme, e sidomos në atë të sundimit të ligjit dhe forcimit



Osmani, si dhe me kryeministrin Albin Kurti. Ndërkaq në takim me Osmanin u diskutua për raportet e shkëlqyera Kosovë - Mbretëria e Bashkuar, përkushtimin për thellim të bashkëpunimit ndërshtetëror, forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës si dhe situatën e sigurisë në rajon e më gjerë. Presidentja Osmani falënderoi sekretarin Cameron për mbështetjen e palëkundur të Mbretërisë së Bashkuar përgjatë viteve, përfshirë edhe mbështetjen diplomatike në procesin e integritetit të Kosovës në institucione ndërkombëtare. Presidentja Osmani ritheksoi rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në NATO, duke filluar me përfshirjen në Partneritetin për Paqe, si hap i domosdoshëm për të siguruar paqe dhe siguri afatgjatë në rajon dhe më gjerë. Ngjashëm, Osmani potencoi rëndësinë e anëtarësimit në

britanike në kuadër të KFOR-it, duke potencuar rëndësinë e bashkëpunimit për sigurinë e kufirit me Serbinë. Në këtë drejtim, presidentja foli edhe për grupet terroriste të mbështetura nga Beogradi të cilat vazhdojnë të krijojnë frikë dhe intimidim brenda komunitetit serb. Pavarësisht kësaj, presidentja Osmani theksoi se Kosova është shembull në rajon sa iu përket të drejtave të komunitetit joshumicë, ndërsa riafirmoi përkushtimin e plotë të Kosovës për ta fuqizuar çdo qytetar pa dallim. Në takimin Kuti - Cameron u theksua vlera dhe rëndësia e marrëdhënieve të forta bilaterale ndërmjet dy shteteve teksa u diskutua për fushat dhe mundësitë e reja të bashkëpunimit dypalësh në shërbim të interesave të përbashkëta dhe të fuqizimit të raporteve të ndërsjella. Kryeministri Kurti e njoftoi

kërcënueset të Serbisë. Ai e falënderoi sekretarin Cameron për kontributin e tij edhe sa ishte kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar dhe mbështetjen e vazhdueshme që ky shtet i ka dhënë Kosovës në çlirim, pavarësimin, demokratizimin, zhvillimin e brendshëm dhe integritetin ndërkombëtar dhe, tash së fundmi, në rritjen e sigurisë përgjatë kufirit me Serbinë me zbarkimin e kontingjentit të parë prej 200 ushtarëve britanikë në tetor të vitit të kaluar në kuadër të misionit të NATO-s në Kosovë. Ndërkaq sekretari Cameron shprehu mirënjohjen e tij për mikpritjen në këtë vizitë që, përveçse është e para e tij në Kosovë, është edhe e para për të jashtë vendit për vitin 2024. Ai u shpreh krenar për mbështetjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës dhe për vendimin dhe qëndrimin për ta njohur sovranitetin dhe pavarësinë e saj. "Unë jam këtu për ta përforcuar faktin që ne ju mbështesim juve. Duam t'ju ndihmojmë në rrafshin e sigurisë, atë të zhvillimit ekonomik, të qeverisjes dhe në të gjitha çështjet me të cilat përballet. Kemi qenë mbështetës afatgjatë të Kosovës dhe do të vazhdojmë të jemi të tillë", ka thënë ai në fillim të takimit. Kjo është vizita e parë e një sekretari të Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë që prej vitit 2016. Sekretari Cameron gjatë kësaj vizite shoqërohej nga i dërguari i Posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach dhe ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott. Kur Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia më 17 shkurt 2008, Mbretëria e Bashkuar u bë një nga vendet e para që e njohu zyrtarisht Kosovën sovranë më 18 shkurt të vitit 2008. David Cameron u emërua sekretar i Shtetit për Çështjet e Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit më 13 nëntor 2023. Ai ka qenë kryeministër i Britanisë së Madhe nga maji i vitit 2010 deri në korrik të vitit 2016.



pasiguri të madhe, paqëndrueshmëri të madhe, një botë me konflikte të mëdha dhe është një kohë kur vendet si Britania duhet t'i mbështesin miqtë tanë, të punojnë ngushtë në aleancat tona të rëndësishme dhe të investojnë në zona që kanë qenë të paqëndrueshme, por që tani po tregojnë shenja të mëdha të stabilitetit dhe progresit. Dhe kjo është arsyeja pse ne duam të vazhdojmë të punojmë me ju", ka thënë ai. Diplomati britanik, po ashtu, ka thënë se shteti i tij do ta ndihmojë Kosovën në sferën e njohjeve. "Është vizita e parë e imja kjo në Kosovë si Sekretar Shteti për Punë të Jashtme. Mbretëria e Bashkuar është mbështetëse e madhe e pavarësisë, sovranitetit dhe do të ndihmojë në sjelljen e njohjeve të reja për Kosovën. Ne jemi këtu për t'ju mbështetur, për t'ju promovuar, për t'ju ndihmuar në të gjitha mënyrat që mundemi", ka deklaruar ai.

të demokracisë në vend gjatë vitit 2023, duke vënë në pah në të njëjtën kohë sfidat e rënda me të cilat u përball shteti i Kosovës, duke përfshirë sulmin e 24 shtatorit, pas të cilit Mbretëria e Bashkuar reagoi menjëherë dhe me vendosmëri duke dërguar trupa shtesë. "Mbretëria e Bashkuar për Kosovën është një partnere e veçantë strategjike si në marrëdhëniet tona bilaterale, ashtu edhe multilaterale. Në këtë kontekst, e falënderova Lordin Cameron për mbështetjen e vazhdueshme në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës", ka deklaruar ministrja Gërvalla. Ajo më tej vlerësoi se Mbretëria e Bashkuar për Kosovën është partnere tejet e rëndësishme brenda NATO-s, pra aty ku Kosova e sheh veten pjesë të synimeve strategjike dhe përcaktimeve parimore të kësaj organizate. Gjatë qëndrimit në Kosovë, Cameroni është takuar edhe me presidenten e Kosovës, Vjosa



Këshillin e Evropës për fuqizimin dhe avancimin e mëtejshëm të drejtave të njeriut. Në takim u diskutua edhe për situatën e sigurisë në rajon dhe më gjerë, me ç'rast presidentja Osmani e informoi sekretarin Cameron për përpjekjet e vazhdueshme destabilizuese të Serbisë, përfshirë aktin e agresionit dhe aktin terrorist kundër Republikës së Kosovës më 24 shtator. Presidentja falënderoi sekretarin Cameron për shtimin e trupave

sekretarin Cameron për arritjet e Kosovës, veçanërisht në tri vitet e fundit, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë demokratik e të sundimit të ligjit. Foli për sukseset dhe sfidat e vitit 2023 dhe përkushtimin e tij dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillim ekonomik krahas luftimit të krimit dhe korrupsionit, ngritje të mirëqenies së qytetarëve përmes punësimit dhe politikave të duhura sociale, dhe garantim të sigurisë dhe paqes në vend përballë sjelljes agresive dhe



INTERVISTË EKSKLUZIVE me Bardhyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”? (19)

Presionet ndaj delegacionit të Kosovës dhe spekulimet rreth Konferencës së Rambujesë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së nëntëmbëdhjetë, ka folur për presionet ndaj delegacionit të Kosovës dhe spekulimet rreth Konferencës së Rambujesë. Ai ka treguar se gjatë dy javëve të para në Rambuje delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë punuan tërësisht të ndarë njëri nga tjetri dhe komunikimi zhvillohej nëpërmjet ndërmjetësuesve të bashkësisë ndërkombëtare. Bardhyl Mahmuti, gjithashtu, ka folur për projekt marrëveshjen që duhej ta nënshkruanin të dyja delegacionet më 20 shkurt 1999 dhe ‘kërcënimin’ që morën delegacionet nga kështjella e Rambujesë në rast se dështon kjo marrëveshje

pozicioneve të forcave serbe në Bosnjë për t’ua imponuar respektimin e zonave të shpallura nga Kombet e Bashkuara si “Zona të sigurisë”, serbët zunë peng 500 ushtarë që ishin me mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në disa vendbanime të Bosnjës. I njëjti skenar u përsërit edhe në maj të vitit 1995, kur 21 kaska blu franceze dhe 13 vëzhgues të OKB-së u zunë peng, ndërsa 150 të tjerë i ngujuan në 9 vendgrumbullime

larga nga Beogradi, ndërsa më 20 mars u tërhoqën nga Kosova edhe 1 400 pjesëtarët e fundit të Misionit Verifikues të OSBE-së. Katër ditë më vonë filluan bombardimet e caqeve serbe në Serbi dhe në Kosovë. Me një fjalë, parashikimet e Adem Demaçit jo vetëm që dolën të sakta, por mund të shiheshin si vërejtje të mos përsëriteshin gabimet e Bosnjës.

PRISHTINË, 4 JANAR -

“Epoka e re”: Gjatë konferencës për shtyp, z. Demaçi shprehu dyshimet e veta rreth mundësisë së ndërhyrjes ushtarake të NATO-s. Pas përfundimit të luftës, dyshimi i lartpërmendur është shfrytëzuar nga kundërshtarët e Demaçit për të treguar se gjoja “ai nuk ka pasur të drejtë rreth parashikimit të rrjedhave të ngjarjeve”, sepse NATO, megjithatë, ndërhyri.

Bardhyl Mahmuti: Një pjesë e konsiderueshme e njerëzve lexojnë vetëm tituj gazetash dhe, mbi bazën e tyre, pretendojnë se dinë çfarë ka ndodhur realisht. Nëse lexojmë me vëmendje qëndrimet e Adem Demaçit, do të shohim se qëndrimi i tij ka qenë i saktë!

Në konferencën e lartpërmendur për gazetarë ai thotë: “Mendoj se



deri sa në Kosovë të jetë Misioni Verifikues i OSBE-së, praktikisht nuk është i mundur intervenimi. Çfarë do të bëhet në të ardhmen unë nuk e di, por tash për tash, përveç kërcënimeve, nuk shoh diçka tjetër nga NATO-ja”. Hipoteza e Adem Demaçit se nuk do të kishte ndërhyrje ushtarake të NATO-s përdërsa “në Kosovë të kishte pjesëtarë të Misionit Verifikues të OSBE-së”, mbështetej në mënyrën e

funksionimit të serbëve gjatë luftës në Bosnjë.

“Epoka e re”: A mund të jepni sqarime për lexuesit tanë për ato zhvillime në Bosnjë që përforconin bindjen se, në kontekst të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, nuk mund të kishte bombardime të NATO-s?

Bardhyl Mahmuti: Në nëntor të vitit 1994, kur NATO-ja filloi bombardimet kundër

të armëve. Ata u lidhën me pranga dhe u vendosën në vende strategjike që mund të ishin caqe të sulmeve të NATO-s. Përmes kësaj forme (mburojës njerëzore) serbët dëshmuan se nuk zgjidhnin mjetet për t’i realizuar qëllimet e tyre.

Pikërisht për të shmangur një mundësi të tillë, më 19 mars 1999 personeli i ambasadave të shteteve anëtare të NATO-s u

“Epoka e re”: Në dhjetë pikat e Deklaratës së Grupit të Kontaktit, që nuk mund të negocioheshin, mungonte mundësia e pavarësisë së Kosovës si zgjidhje pas përfundimit të periudhës kalimtare trevjeçare. A ka ndikuar një gjë e tillë në përforcimin e dyshimeve për zgjidhjen e çështjes së Kosovës në këtë konferencë?

Bardhyl Mahmuti: Edhe rreth kësaj çështjeje dyshimet e Adem Demaçit dolën plotësisht të sakta. Gjatë dy javëve të para në Rambuje delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë punuan tërësisht të ndarë njëri nga tjetri dhe komunikimi zhvillohej nëpërmjet ndërmjetësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, Christopher Hill (Kristofer Hill), Wolfgang Petritsch-it (Volfgang Petriq) dhe Boris Majorski-t. Më 19 shkurt 1999, një ditë para

përfundimit të afatit për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët, delegacionit të Kosovës dhe atij serbo-jugosllav iu dha projekt marrëveshja që duhej ta nënshkruanin të nesërmen, më 20 shkurt.

Drafti final i dorëzuar më 19 shkurt kishte ndryshime thelbësore në krahasim me “Projekt marrëveshjen kalimtare për paqe dhe për vetëqeverisje në Kosovë” të datës 6 shkurt.

Fillimisht po tërheq vëmendjen e lexuesit te fakti se delegacioni serb ishte kategorikisht kundër nënshkrimit të marrëveshjes, sepse nuk pajtohej me modalitetin e autonomisë së Kosovës dhe praninë ushtarake ndërkombëtare për ta mbikëqyrur implementimin e kësaj marrëveshjeje. Serbët kërkuan kohë që të konsultoheshin me Beogradin për një gjë të tillë. Mirëpo, në vend të autonomisë substanciale, si status kalimtar deri në zgjidhjen përfundimtare që parashihej të përcaktohej pas tre vjetësh, drafti i ri e parashihte këtë formë si zgjidhje përfundimtare. Një ndryshim i tillë ishte i papranueshëm për delegacionin shqiptar të Kosovës. Lexuesit, që i intereson të njihet me dinamikën që ngjalli ky draft në kuadër të delegacionit shqiptar, i sugjeroj veprat e autorëve Rexhep Qosja, Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Blerim Shala dhe Edita Tahiri, të cilët ishin dëshmitarë të atyre ngjarjeve si pjesë e delegacionit të Kosovës. Bllokimi i bisedimeve solli para një situatë të vështirë diplomacinë e shteteve të Grupit të Kontaktit për Kosovën. Në këtë kontekst, Sekretarja e Shtetit Amerikan, Madeleine Albright, më 20 shkurt 1999, nga kështjella e Rambujesë, iu drejtua palëve në bisedime me një gjuhë të qartë kërcënuese: “Merrini gjërat seriozisht! Kësaj radhe nuk mund të lejojmë që dikush të shtiret! Nëse serbët thonë ‘JO!’ dhe bisedimet dështojnë për shkak të tyre, atëherë do të kemi bombardime! Nëse shqiptarët nuk thonë ‘PO!’ dhe bisedimet dështojnë për shkak të tyre, ne nuk do t’i mbrojmë dhe, rrjedhimisht, nuk do të ketë bombardime kundër Serbisë!”

“Epoka e re”: Ndërkohë që zhvilloheshin bisedimet në Rambuje dhe delegacioni i Kosovës ballafaqohej me presione të ndryshme, që janë të kuptueshme në kontekst të bisedimeve të kësaj natyre, në Kosovë ndodhën ndryshime në kuadër të UÇK-së. Komandantët e zonave operative emëruan komandant të përgjithshëm të UÇK-së z. Sylejman Selimi. Si i keni parë këto zhvillime në atë kohë?

Bardhyl Mahmuti: Është fakt i pakontestueshëm se kjo çështje zuri një vend tejet të rëndësishëm në qarqet politike ndërkombëtare, të përfshira në gjetjen e një zgjidhjeje politike për Kosovën. Për të gjithë u bë e qartë se delegacioni i Kosovës nuk mund të vendoste nënshkrim mbi diçka që mbyllte rrugën e pavarësisë së Kosovës. Për këtë arsye u organizuan takime të shumta të

diplomatëve perëndimorë me Adem Demaçin dhe me personalitete të politikës, shkencës dhe artit të Republikës së Shqipërisë (Rexhep Mejdani, Pandeli Majko Paskal Milo, Sabri Godo, Ismail Kadare), me qëllim që të ndikohej për nënshkrimin e projekt marrëveshjes. Hashim Thaçi, si udhëheqës i delegacionit të Kosovës, dhe përfaqësuesit e tjerë të UÇK-së, që ishin në kuadër të këtij delegacioni, treguan urtësinë e duhur. Jo vetëm që nuk kundërshtuan krijimin e një strukture komanduese në rrafshin operativ të UÇK-së, por, përkundrazi, ia uruan Sylejman Selimit detyrën e re!

“Epoka e re”: Çfarë mund të ndodhte nëse kundërshtohej vendimi i komandantëve të zonave operative? Bardhyl Mahmuti: Gjatë gjithë kohës së luftës ndikimi i Drejtorisë Politike te komandantët e zonave operative ka qenë tejet i vogël dhe vende-vende pa asnjë ndikim. Çfarëdo forme e kundërshtimit të vendimit të komandantëve të zonave mund të nxiste reagime të paparashikueshme dhe, në këtë mënyrë, të krijoheshin telashe të mëdha rreth legjitimitetit të përfaqësimit të UÇK-së! Pa marrë parasysh realitetin e raporteve Drejtori Politike/komandantë të Zonave Operative nuk ishte në interes të Kosovës që të shpërfaqeshin divergjenca në këtë moment vendimtar për ardhmërinë e vendit!

“Epoka e re”: A ka mundur z. Azem Sylja ta perceptojë emërimin e z. Sylejman Selimi në detyrën e komandantit të përgjithshëm të UÇK-së si goditje kundër tij? Bardhyl Mahmuti: Jo! Nuk besoj! Vendimi i lartpërmendur i komandantëve të zonave ishte përpjekje për ta krijuar Shtabin e Përgjithshëm si organ komandues të forcave ushtarake, në krye të së cilës u caktua Sylejman Selimi, ndërsa funksioni i Azem Sylës ka qenë përfaqësimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e jo i strukturës që komandonte në terren! Në vendimin e komandantëve të zonave operative për ta caktuar Sylejman Selimin komandant të Shtabit të Përgjithshëm as që përmendet zëvendësimi i Azem Sylës, sepse kishim të bënim me aspektin komandues të forcave të armatosura. Siç e dini, pas ndërprerjes dyjavore të konferencës dhe kthimit të delegacionit në Kosovë, delegacioni përfaqësues i UÇK-së mbeti i njëjtë edhe për raundin e dytë të bisedimeve: Sylejman Selimi nuk e zëvendësoi Azem Sylën në delegacionin që përfaqësonte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në Konferencën e Rambujesë. Një gjë e tillë nuk ndodhi as kur Sylejman Selimi u zëvendësua nga gjeneral Agim Çeku. Madje, në kuadër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, që doli si rezultat i marrëveshjes së forcave politike pjesëmarrëse në Rambuje, Azem Sylja ishte ministër i Mbrojtjes e jo pjesë e strukturave komandues të

Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.

“Epoka e re”: Kur flitet për ato momente plot tensione dhe presion të gjithanshëm ndaj delegacionit të Kosovës që të n ë n s h k r u a n t e projekt marrëveshjen, kohën e fundit është bërë e ditur nga vetë z. Sylejman Selimi dhe komandanti i Zonës Operative të Llapit, z. Rustem Mustafa, se i ishin kërcënuar delegacionit të Kosovës në Rambuje se do të ballafaqohej me pasoja të rënda kushdo që do të nënshkruante një draft të tillë. Deri në çfarë mase kanë ndikuar këto kërcënime që të refuzohej nënshkrimi i menjëhershëm i marrëveshjes?

Bardhyl Mahmuti: Kërcënimet që janë bërë publike nga vetë protagonistët e atyre ngjarjeve nxjerrin në pah mungesën e një strukture unike, që manifestohej vazhdimisht edhe nëpërmjet publikimit të komunikatave në emër të Zonave Operative, deklaratave të zëdhënësve të këtyre zonave, intervistave të komandantëve të tyre e kështu me radhë. Kërcënimet e këtij niveli ishin serioze dhe askush nuk mund t’u qasej me mos përfillje! Mirëpo, edhe pa kërcënimet e lartpërmendura unë nuk besoj se ndonjëri nga përfaqësuesit politikë të UÇK-së do të kishte nënshkruar variantin e projekt-marrëveshjes që u shtrua në tavolinë më 19 shkurt.

Sidoqoftë, ky kontekst shtroi si domosdoshmëri nevojën për të sqaruar shumë gjëra që lidheshin me projekt-marrëveshjen. Në funksion të kësaj strategjie, udhëheqësi i delegacionit të Kosovës, Hashim Thaçi, udhëtoi në Lubjanë të Sllovenisë për t’u takuar me Adem Demaçin, Më në fund, takimet intensive të Hashim Thaçit me diplomatët amerikanë siguruan premtimin gojor se çështja e autonomisë substanciale do të mbetej si zgjidhje e përkohshme gjatë fazës kalimtare trevjeçare dhe pas përfundimit të kësaj faze, do të respektohej vullneti politik i popullit të Kosovës. Ishte e qartë se në këtë periudhë diplomacia ndërkombëtare dëshironte t’i jepte fund gjenocidit në Kosovë. Këmbëngulja e pranisë ushtarake në Kosovë nënkuptonte heqjen e ushtrimit praktik të sovranitetit të Serbisë në Kosovë, ndërkaq heqja juridike e Kosovës nga Serbia mbetej të diskutohej pas fazës kalimtare. Pikërisht për këto arsye, nëpërmjet letrës së 23 shkurt 1999, delegacioni i Kosovës njoftoi ndërmjetësuesit ndërkombëtarë se parimisht pranonte marrëveshjen e përkohshme për paqe.

Në situatë të tillë, ku delegacioni serbo-jugosllav refuzonte kategorikisht nënshkrimin e marrëveshjes, ndërkaq delegacioni i Kosovës kishte dhënë pohimin se do ta nënshkruante marrëveshjen, organizatorët e konferencës vendosën që t’i ndërpritnin punimet për një afat 2-3 javësh dhe ta rifillonin takimin në Paris më 15 mars 1999. Një vendim i tillë i përshtatej edhe delegacionit

tonë, sepse afati shtesë do të shërbente për të sqaruar komandantët e zonave operative rreth zhvillimeve në Rambuje.

“Epoka e re”: A mjaftoi premtimi gojor i diplomatëve amerikanë për të besuar se çështja e pavarësisë së Kosovës mbetej si opsion për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës?

Bardhyl Mahmuti: Fjala e diplomatëve amerikanë ka një shkallë të lartë besueshmërie. Ata që nuk besuan në fjalët e tyre, qoftë edhe kur kërcënoheshin, i bartën pasojat mbi kurrizin e vet, siç ishte rasti i Serbisë. Ndërkaq vërtetësia e premtimit se autonomia substanciale ishte e vlefshme gjatë fazës kalimtare u dëshmuar gjatë procesit të përcaktimit të statusit final të Kosovës: Kosova u shpall shtet i pavarur dhe kjo pavarësi u njoh menjëherë nga ShBA-ja!

“Epoka e re”: Meqenëse jemi te premtimet gojore, a u hoqën presionet dhe kërcënimet ndaj nesh pas deklaratave të delegacionit të Kosovës se do ta nënshkruanin marrëveshjen?


Bardhyl Mahmuti: Po! Refuzimit kategorik të projekt marrëveshjes nga ana e delegacionit serbo-jugosllav, premtimi nga ana e delegacionit të Kosovës se do ta nënshkruante marrëveshjen ishte i mjaftueshëm.


“Epoka e re”: Pas ndërprerjes së bisedimeve në Rambuje, më 24 shkurt 1999, delegacioni i Kosovës udhëtoi për në Prishtinë, përveç udhëheqësit të delegacionit, z. Hashim Thaçi dhe z. Xhavit Haliti, të cilët udhëtuan për në Tiranë. A keni njohuri rreth asaj si u zhvilluan konsultat e përfaqësuesve të UÇK-së me Shtabin e Përgjithshëm, sepse ka

thashetheme të ndryshme?

Bardhyl Mahmuti: UÇK-ja vazhdimisht është ballafaquar me një luftë të ashpër speciale të shpërndarjes së gënjeshtrave nga ana e Shërbimit Sekret të Serbisë dhe shërbëtorëve të tij me qëllim të ngjalljes së mosbesimit ndaj saj te diplomatët e shteteve demokratike. Në funksion të këtij qëllimi janë sajuar me qindra “kumtesa”, “raporte”, “procesverbale” dhe janë shpërndarë si “dokumente” të UÇK-së, si “deklarata të përfaqësuesve të saj politikë” etj. Një numër të konsiderueshëm të këtyre sajeseve i kam pasur të sistemuara në kompjuterin tim me qëllim që t’i përfshij në projektin që kisha për shkrimin e librit “Mashtrimi i madh” por, nëse nuk gaboj, në vitin 2001, në të njëjtën kohë kur pati sulm kibernetik “Kosovapress”-i, sulmuan edhe kompjuterin tim dhe më shkatërruan një numër të madh të shënimeve që kisha rreth takimeve diplomatike, njoftimeve që kisha bërë si shef i Grupit Diplomatik të UÇK-së, sajeseve të lartpërmendura, projektit të doktoratës etj. Sa iu përket manipulimeve të kësaj natyre që u bënë lidhur me konsultat e përfaqësuesve të UÇK-së me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, pas kthimit nga Konferenca e Rambujesë, po përmend shpërndarjen e një “procesverbal” të falsifikuar lidhur me këtë takim!

“Epoka e re”: Çfarë përmbante procesverbalin i falsifikuar dhe si mund të bindemi se është i sajuar? Bardhyl Mahmuti: Përpara se të ndalemi dhe ta zbërthejmë “procesverbalin” në fjalë, po e publikojmë tekstin e plotë (dy faqe) që lexuesi të ketë mundësi ta shohë saktësinë e çmontimit të kësaj sajese.





Sipas këtij “procesverballi” të publikuar nga një agjenci e shpifur (“Kaçakpress”), që pretendon se e “ka marrë nga burimi i saj i sigurt”, takimi ka ndodhur më 6 mars 1999 në Drenicë! Nëse shikoni me vëmendje, do të vëreni se në krye të faqes së parë, data shkruhet në anglisht “Date: 07 March 1999” dhe pretendohet se është transmetuar 8 minuta pas mesnatës (00:08), ndërkaq, në krye të faqes së dytë del se është lëshuar në muajin maj të vitit 1995, në orën 22:03!!! Domethënë faqja e dytë është dërguar me faks rreth katër vjet përpara se të dërgohet faqja e parë e “Mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”! Imagjinoni, katër vjet përpara se të ndodhnin ngjarjet, sajuesit e këtij “procesverballi” e paskëshin ditur se kur do të mbahet Konferenca e Rambujesë, se kush do ta përfaqësojë UÇK-në, se si do të emërohet Sylejman Selimi komandant i përgjithshëm, se kush do të mernte pjesë në atë mbledhje!!! “Parashikime” të jashtëzakonshme të këtij “burimi

Gjarpni”) paskësh qenë “duke përgatite valigjet për me shku në Washington”!!! Në atë kohë udhëheqësi i delegacionit të Kosovës ishte në Kosovë dhe zhvillonte bisedime për t’i harmonizuar qëndrimet rreth projektmarrëveshjes që do t’i jepte fund luftës. Më 13 mars Hashim Thaçi, së bashku me anëtarët e tjerë të delegacionit, udhëtoi me aeroplan ushtarak nga Aeroporti i Prishtinës për në Paris, ndërkaq “valixhet e gatshme për Washinton” ua la “gazetarëve të Kaçakpress”-it!

“Epoka e re”: Në veprën autoriale “Kosova në krizën jugosllave” z. Ramë Buja saktëson se takimi i përfaqësuesve politikë të UÇK-së me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kishte ndodhur dy ditë pas kthimit nga Rambujeja, më 26 shkurt 1999. A u besoi kush broçkullave të këtij “procesverballi” të falsifikuar? **Bardhyl Mahmuti:** Nëse mbështetemi në shkrimet dhe intervistat e pjesëmarrësve të asaj mbledhjeje del se në këtë takim nuk është thënë asnjë nga fjalët e sajua nga “Kaçakpress”. Për

edhe sot e kësaj dite të tillë që u besojnë broçkullave të tilla. Përkundër asaj se në mbledhjen e lartpërmendur u vendos të mbështetej delegacioni i Kosovës, ndërkaq Hashim Thaçi u emërua mandatar për formimin e Qeverisë së Përkohshme, fatkeqësisht ka pasur dhe ka edhe sot e kësaj dite të tillë që u besojnë thashethemeve dhe sajeseve të kësaj natyre, që kishin për efekte përçarjen brenda shqiptarëve.

“Epoka e re”: Mendoni se ka edhe sot të tillë që vazhdojnë t’u besojnë sajeseve të tilla?! **Bardhyl Mahmuti:** Fatkeqësisht një numër i konsiderueshëm i veprimtarëve që interpretojnë zhvillimet e atëhershme brenda LPK-së dhe UÇK-së si rezultat “komplotesh”, të cilët nuk meritojnë t’ua përmend as emrin, vazhdojnë t’i shpërndajnë sajesat e tilla! Madje libri i fundit që merr për të vërtetë sajesën e shpërndarë në emër të agjencisë së shpifur “Kaçakpress” dhe e prezanton si “Faksimil i Mbledhjes së datës 07 mars 1999, i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së”, është botuar në vitin 2021!

“Epoka e re”: A mund të zbulohet se kush e ka përpiluar “procesverbalin” e lartpërmendur dhe kush qëndronte prapa agjencisë “Kaçakpress”? **Bardhyl Mahmuti:** Gabimet e shumta sintaksore dhe drejtshkrimore lënë të dyshohet se prapa sajesës së tillë mund të qëndrojë dikush nga Beogradi. Gabimet gjuhësore mund të bëhen edhe qëllimisht për ta rritur shkallën e besueshmërisë në vërtetësinë e përmbajtjes, duke pasur parasysh dobësitë që na karakterizojnë në drejtshkrim! Mirëpo, shkrimi i tekstit të “procesverballit” në një faqe të faksuar në maj të vitit 1995, nuk mund të jetë gabim i ndonjë agjenti të Sigurimit Shtetëror të Serbisë në Beograd, sepse ata janë përpjekur të mos bëjnë gabime që duken nga aeroplani! Mendoj se një gabim të tillë kanë mundur ta bëjnë agentët e llojit të Nazim Bllacës apo të agentëve të tjerë që sajuan agjencinë “Kaçakpress”!

“Epoka e re”: T’i kthehemi kontekstit të bisedimeve të raundit të parë në Konferencën e Rambujesë dhe të sqarojmë një çështje që është përfolur shumë. Meqenëse delegacioni serbo-jugosllav refuzonte nënshkrimin e marrëveshjes, çfarë do të ndodhte nëse delegacioni i Kosovës do ta nënshkruante menjëherë? A mund të supozohet se ndërhyrja ushtarake do të kishte ndodhur përpara datës 24 mars dhe, rrjedhimisht, lufta do të kishte përfunduar më herët? **Bardhyl Mahmuti:** Një hipotezë e tillë kishte gjasa të vogla të realizohej. Mendimin tim e mbështes në mënyrën e veprimit të aktorëve ndërkombëtarë të përfshirë në gjetjen e zgjidhjes për çështjen e Kosovës. Po marr dy shembuj që lidhen me rastin tonë: Më 15 mars 1999 shefi i delegacionit të Kosovës, Hashim Thaçi, i njoftoi ndërmjetësuesit

ndërkombëtarë se “pas konsultimeve dhe pas marrjes së mendimeve nga pjesa dërmuese e popullit delegacioni i Kosovës e pranon marrëveshjen. Ne mendojmë se kështu i kontribuojmë paqes në rajon.” Në të njëjtën ditë, delegacioni i Kosovës nënshkroi marrëveshjen dhe mbajti një konferencë për shtyp, ku u njoftua opinioni publik ndërkombëtar për vendimet që ishin marrë. Edhe pse delegacioni serb refuzoi edhe aspektin politik, edhe atë të pranisë ushtarake për ta mbikëqyrur implementimin e marrëveshjes eventuale, diplomacia e shteteve të Grupit të Kontaktit vazhdoi përpjekjet për ta bindur Serbinë. Që nga 15 marsi e deri më 22 mars nuk u ndërprenë përpjekjet për ta përmbyllur këtë konferencë me sukses të përgjithshëm. Më 22 mars dështoi përpjekja e fundit e ambasadorit Holbrooke për ta bindur Sllobodan Millosheviqin që ta pranonte marrëveshjen e nënshkruar nga delegacioni shqiptar. Të nesërmen, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, deklaroi se i kishte dhënë urdhër gjeneralit Wesley Clark t’i fillonte operacionet ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë. Të njëjtën gjë e pamë edhe në procesin e negociatave në Vjenë për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Nga data 20 shkurt e vitit 2006 e deri më 8 shtator të të njëjtit vit, delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë zhvilluan 11 raunde bisedimesh. Më 2 shkurt 2007 i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisaari, ua dorëzoi të dy delegacioneve pakon e propozimeve lidhur me statusin final të Kosovës dhe ftoi palët të angazhoheshin në një proces konsultimesh. Përfaqësuesit e Kosovës u deklaruan pozitivisht për pakon e propozimeve, ndërsa përfaqësuesit e Serbisë u shprehën kategorikisht kundër. Përkundër konkluzionit të Marti Ahtisaarit se “vazhdimi i bisedimeve, në cilëndo formë qoftë, nuk do të mundësonte të dilej nga ky qorrsockak”, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara kërkoi nga Grupi i Kontaktit që të bënte edhe një përpjekje për t’i përafruar pikëpamjet diametralisht të kundërta të palëve. Negociatat e reja, të parapara të zhvilloheshin gjatë 120 ditësh dhe të përfundonin më së voni deri më 10 dhjetor 2007, duhej të zhvilloheshin nën drejtimin e një “Tresheje” të përbërë nga përfaqësuesit e ShBA-së, Rusisë dhe BE-së. Treshja e ngarkuar nga Grupi i Kontaktit, që përbëhej nga ambasadori gjerman Wolfgang Ischinger, Alexander Bostan–Harchenko dhe Frank Wiesner, zhvilloi këto negociata nga 9 gushti deri më 3 dhjetor 2007. Rrjedhat e mëtutjeshme dihen: Serbia nuk pranoi as rekomandimet që dolën nga përpjekjet e kësaj “Tresheje”, Kosova mbajti zgjedhje të reja dhe

më 17 shkurt shpalli pavarësinë, që e njohën mbi 100 shtetet të botës. Prandaj mendoj se do t’i jepej edhe një afat Serbisë për ta ndryshuar qëndrimin edhe në rast se delegacioni i Kosovës vinte nënshkrimin gjatë raundit të parë! **“Epoka e re”:** Shpesh dëgjohet se falë Serbisë që refuzoi marrëveshjen e paqes të propozuar në Konferencën e Rambujesë, ne shpëtuam se, përndryshe, marrëveshja do të na kishte lënë në kuadër të integritetit territorial të Jugosllavisë, me një “autonomi substanciale”! Cili është mendimi juaj? **Bardhyl Mahmuti:** Spekulumet e kësaj natyre janë tërësisht të paqëndrueshme. Delegacioni serbo-jugosllav nuk ka mundur të nënshkruajë një marrëveshje për çfarëdo forme të autonomisë së Kosovës, realizimin e së cilës duhej ta garantonin forcat ushtarake ndërkombëtare, për arsye se Serbia si shtet kishte përpiluar planin e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Kjo që them nuk është hipotezë e imja, por pohim i Ratomir Tanić-it (Ratomir Taniq), i cili ka qenë anëtar i delegacionit të Serbisë që zhvilloi bisedime me delegacionin e Kosovës nga viti 1994 e deri në vitin 1997 me qëllim të shmangies së luftës dhe të gjetjes së një zgjidhjeje politike për Kosovën. Mirëpo, sipas Taniqit, Millosheviqi shkatërroi rezultatet e punës që kishin bërë gjatë bisedimeve, sepse i duhej lufta për ta luajtur rolin e shpëtimtarit të Serbisë!... Ta izolosh terrorizmin është një çështje krejt tjetër nga vrasja e grave dhe e fëmijëve siç është krejtësisht tjetër të shpërngulësh një popull të tërë. Forcat tona të sigurisë nuk bënë aspak luftë kundër terroristëve. Ata luftën e bënë kundër popullatës civile. Kështu filloi konflikti etnik në mars të vitit 1998. Në vend të arrestimit të vëllezërve Jashari dhe të tjerëve, forcat tona sulmuan shtëpitë ku jetonin ata dhe masakruan gratë, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes. Në vend që të kufizoheshin aksionet në caqet e caktuara, u sulmuan edhe fqinjët e tyre... Sigurisht që kjo provokoi revoltën e popullit shqiptar, siç do ta provokonte revoltën e cilitdo popull në botë. Millosheviqi e dinte se kjo do ta provokonte kryengritjen e popullit shqiptar dhe e bëri vetëm e vetëm që të kishte mundësi të arsyetohej se kishim të bënë me një revoltë! Millosheviqi dhe Shahinoviqi vepronin në atë mënyrë që “lufta kundër terrorizmit” të kthehej në luftë kundër fshatrave dhe civilëve shqiptarë”. Prandaj hipotezat e natyrës “nëse delegacioni i Kosovës do të nënshkruante...” shtrohen nga njerëz që kërkojnë qime në vezë! Delegacioni i Kosovës në Rambuje ka luajtur një rol tepër konstruktiv për përfundimin e luftës në Kosovë dhe dhënien fund të gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve!

(Muhamet Mavraj / Vijon)

Murtezaj: Njohjet nga pesëshja e BE-së, sfida për Kosovën në vitin 2024

PRISHTINË, 4 JANAR - Profesori i negocimit dhe diplomacisë në Paris të Francës, Valon Murtezaj, ka vlerësuar se njohjet nga pesë vendet e Bashkimit Evropian (BE) mbeten sfidat më të vështirë të Kosovës në politikën e jashtme në vitin 2024.

Ai në opinionin e shkruar për "Epokën e re", ka thënë se "anëtarësimi në Këshillin e Evropës do të ishte arritje e madhe për Kosovën nëse kjo do të ndodhte në vitin 2024".

"Njohjet nga pesë vendet e Bashkimit Evropian (Greqia, Rumania, Qipro, Sllovakia, dhe Spanja) mbeten sfida të vështirë, në të njëjtën kohë mundësi e artë për Kosovën. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës do të ishte arritje e madhe për Kosovën nëse kjo do të ndodhte në vitin 2024. Prandaj, në mënyrë specifike këtu do të duhej të ishte angazhimi i fuqishëm dhe i plotë i Kosovës për të avancuar në këtë drejtim. Diplomacia

publike dhe dimensionet e tjera të diplomacisë duhet të jenë përkrahëse dhe të zhvillohen me intensitet dhe mençuri dhe përgatitje në mënyrë që efekti të jetë global. Sidoqoftë, Republika e Kosovës tanimë është në hartën e shteteve të pavarura të botës, dhe rruga e saj për forcim të pozicionit në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare sado e vështirë të jetë, do të jetë e suksesshme", ka shkruar Murtezaj.



Indiferenca ndaj Gjykatës Speciale



Shkruan: Sali BISLIMI

Si kuptohet logjika e heshtjes, e politikës së Kosovës dhe klasës intelektuale akademike që ka vendi, shoqërisë së lirë dhe të OJQ-ve të ndryshme që nuk janë në nivelin e duhur për ta mbrojtur interesin vital të Kosovës, pengjet në Hagë. Kur politika ndërkombëtare favorizoi Vuçiqin si ministër i kabinetit të Millosheviqit për qindra masakra në Kosovë, ajo me turp merret me Kosovën dhe lirinë e saj duke vënë në bankën

e të akuzuarve ata që luftuan dhe u mbrojtën nga kasapi i Ballkanit. Te shqiptarët si kuptohet heshtja ku humbi guximi për t'i thënë kolektivisht Hagës se lloji i kësaj gjykate nuk bën drejtësinë për ta krijuar paqen afatgjatë përderisa serbët nuk janë pjesë e saj. Kjo gjykatë ishte detyrim për ta themeluar, por ajo sot abuzon me qëndrimet dhe formën që trajton, mbi të gjitha, ish-presidentin Hashim Thaçi si një

lider i luftës, paqes dhe integritit në vlerat euroatlantike të Kosovës si shembull për rajonin. Kohëzgjatja e këtij gjykimi është dëshmia tjetër se mungojnë faktet për t'i gjykuar sepse që nga fillimi ishte vetëm një paragjykim dhe do të përfundojë si e tillë, vetëm humbja e viteve është e dhimbshme, sepse ata janë heronjtë tanë që me shekuj Kosova i ka pritur. Shpresa e vetme është që në atë

gjykatë janë amerikanët me të cilët së bashku fituam lirinë, dhe besoj që së bashku me ta do ta fitojmë edhe këtë betejë të drejtësisë anti-shqiptare. Llojin e patriotëve si kërpudhat pas shiut është shembulli më i keq që u servohet gjeneratave të reja, pos që është i ulët, nuk është edhe mentalitet evropian. Andaj, Kosovë, mos u vono, tregojë veten, jepi zë historisë së lavdishme, mos të zë turpi se të humbet lavdia!

Sveçlës i refuzohet vizita në Luginë të Preshevës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 JANAR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se autoritetet në Serbi i kanë refuzuar kërkesën për vizitë në Luginën e Preshevës. Sveçla ka thënë se kërkesa i është refuzuar pa arsyetim dhe se "ky akt i Serbisë ndaj vizitës sime dëshmon qasjen destruktive dhe shtypjen e vazhdueshme të saj ndaj shqiptarëve të Luginës".

Përmes një shkrimi në "Facebook", më 4 janar, Sveçla ka thënë se për çështjen e vizitave të zyrtarëve shtetërorë do të veprojnë mbi parimet e reciprocitetit. Ai ka thënë se përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kishte përcjell agjendën në zyrën ndërlidhëse të Serbisë për leje të hyrjes dhe realizim të vizitës, "në respektim të marrëveshjes së Brukselit dhe praktikave të deritanishme". "Ky refuzim pa asnjë arsyetim nga Serbia disa orë para realizimit të vizitës, nuk zbehtë qëllimet dhe angazhimin tonë për shqiptarët e Luginës.

Ndër të tjera, nuk do të zbehtë as dëshirën dhe qëllimin tim për realizim të vizitës atje, për të ndarë me shqiptarët e Luginës shqetësimet e padrejtësitë me të cilat ata ballafaqohen dhe angazhimet e institucioneve të Republikës sonë për ta", ka shkruar ai.

Sipas ministrit të Brendshëm, ai do të zhvillonte vizita në Preshevë, komunë e banuar me shumicë shqiptare, dhe në Medvegjë dhe Bujanoc, ku gjithashtu banojnë shqiptarë.

Refuzim të kërkesave të zyrtarëve kosovarë për vizitë në komunat jugore të Serbisë - të banuara me shumicë shqiptare - kishte pasur edhe më parë. Më 27 nëntor të vitit 2021 autoritetet në Serbi kishin refuzuar kërkesën e katër ministrave për vizitë dyditore në atë që njihet si Luginë e Preshevës.

Refuzimi i kërkesës për vizitë në Serbi kishte ardhur pasi më 23 nëntor Qeveria e Kosovës kishte refuzuar kërkesën për vizitë në Kosovë të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković.



Tahiri: 2024, vit zgjedhor. Kjo qeveri i ka shkaktuar dëme të mëdha Kosovës

PRISHTINË, 4 JANAR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se viti 2024 është vit zgjedhor për shkak se edhe për zgjedhjet e rregullta ato duhet të shpallen më së herët gjashtë muaj, më së voni katër muaj para zgjedhjeve. Sipas Tahirit, kjo nënkupton

që partitë politike do të punojnë për përpilimin e listave dhe zgjedhjeve. "Problem nuk është përcaktimi i zgjedhjeve të parakohshme apo të rregullta. Problem është që kjo qeveri është duke i shkaktuar dëme të mëdha Kosovës dhe është duke e dëmtuar në rrafshin e

brendshëm. Në veçanti, në varfërimin dhe në ekonominë e Kosovës, e cila është në rrafshin më të ulët në historinë e vet. Andaj, sa më shpejt që shkon kjo qeveri, aq më mirë do të jetë për Kosovën dhe për qytetarët e saj", ka thënë Tahiri në një video të postuar në "Facebook".



Liberalizimi i vizave, më së shumti do të pësojë sektori privat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 JANAR - Njohësi i çështjeve ekonomike, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se nga liberalizimi i vizave më së shumti do të pësojë sektori privat në Kosovë. “Në aspektin ekonomik besoj se do të ketë ndikim te sektori privat në Kosovë. Duhet të pranohet e vërteta që Kosova nuk u zbraz vetëm nga ky vit, por ka filluar me vite të tëra. Të fundit që po braktisen nga Kosova nuk po ikin vetëm të papunët dhe skamnorët, por po largohen edhe familje me stabilitet ekonomik dhe social, sepse e kanë brengën e edukimit, të shëndetësisë, e kanë brengën e sigurisë së perspektivës dhe shumë mënyrave të tjera të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për këtë arsye mendoj se në një aspekt kohor afatshkurtër do të kemi një tentativë për t’u larguar nga Kosova. E tëra kjo do ta ketë koston e vet ekonomike jo vetëm që do të ketë nevojë sektori privat, por këta që mendojnë për t’u larguar do të krijojnë edhe humbje të shumta ekonomike dhe ky do të jetë një dëm”, ka

thënë Gërxhaliu për gazetën “Epoka e re”.

Ai ka thënë se ka munguar një kampanjë vetëdijesuese e institucioneve të vendit që t’i ndalin të rinjtë këtu. “Në rend të parë duhet të kuptohet që Evropa nuk është ajo që ka qenë më parë dhe sot disa shtete evropiane janë në një recension ekonomik dhe kjo e dëmton pozitën e tyre. Në anën tjetër, besoj se duhet të kontrollohet komunikimi i pushtetarëve të Kosovës të cilët Kosovën e paraqesin si një shtet të përkohshëm. Çdo ditë kemi paralajmërime për luftë dhe për konflikt dhe jo për avancim të dialogut dhe stabilitet politik, dhe kur këto fjalë dominojnë atëherë vetvetiu krijohet një panik apo një ankth i cili i bën qytetarët të mendojnë të largohen nga Kosova. Duhet shumë punë për të bërë për të qëndruar në Kosovë. Krejt kësaj kur i shtohet një fakt tjetër që ne kemi zyrtarë shumë të lartë qeveritarë të cilët e argumentojnë migrimin e kosovarëve se kinse edhe evropianët migrojnë. Besoj është një prononcim shumë i rrezikshëm. Ky gabim është i rrezikshëm nga fakti se vendet evropiane nuk e kanë armik

Serbinë siç e ka Kosova dhe nuk e kanë një akademi të shkencave serbe siç e ka Serbia e cila harton drafte dhe strategji për ta zbrazur Kosovën, sepse për armiqtë vetëm Kosova e zbrazët është Kosovë e mirë dhe e dëshiruar. Për këtë arsye duhet të kemi kujdes me deklaratat dhe të punohet më tepër që të kthehet besimi i humbur nga qytetarët e Kosovës për të jetuar në Kosovë”, është shprehur ai.

Edhe kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës (SPSPK), Jusuf Azemi, ka thënë për “Ekonomia Online” se liberalizimi i vizave do të ndikojë edhe në sektorin privat. Sipas tij, pronarët e kompanive të ndryshme gjashtëmujorin e parë të këtij viti e kanë një lloj testi si mundësi e fundit për ofrimin e kushteve më të mira të punës para se të ketë mungesë të fuqisë punëtore. “Vetëm ata të cilët nuk e kanë parë gjendjen reale, e dinë që edhe këtë vit ka mungesë punëtorësh. Unë pres që në pjesën e dytë të këtij viti të kemi një shpejtim, një fluks më të madh të njerëzve që të ikin nga Kosova me kusht që të gjejnë një punë më të mirë. Pronarët e kompanive e kanë një lloj testi në

gjashtëmujorin e parë të këtij viti në mënyrë që të ofrojnë kushte që i përmbush Ligi i Punës dhe Marrëveshja Kolektive, por nëse vazhdojmë me këtë gjendje si është te punëtorët dhe sektori privat, është ngulit diçka që duhet me ik patjetër”, ka thënë Azemi.

Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se në një shtet i cili ka një orientim më shumë social tregon për mungesë vizioni, për një qëndrueshmëri ekonomike dhe një garanci drejt ardhmërisë. “Për këtë arsye, e pranua apo jo të vërtetën, Kosova është shndërruar më tepër në një shtet social sesa në një shtet zhvillimor. Nuk kemi të bëjmë këtu vetëm me thirrje publike për subvencionim të pajisjeve efçente apo për disa skema sociale, por në përgjithësi orientimet buxhetore për vitin 2024 janë të drejtuara në këtë drejtim. Kjo është një qasje e cila nuk garanton stabilitet ekonomik dhe në qoftë se një shtet nuk ka stabilitet ekonomik dhe një vizion për stabilitet ekonomik, është topike të arrihen stabiliteti social, politik dhe të përshpejtohen proceset integruese e të jemi të

përshpejtuar në përmirësimin e imazhit të Kosovës. Një politikë e tillë është më tepër ad-hoc sesa zhvillimore. Lind gjithmonë pyetja çka kur të shpenzohen këto ndihma të ofruara dhe a mund të mbijetojë shteti vetëm me skema sociale? Duhet vërtet të jemi të orientuar drejt një ekonomie më të zhvilluar. Pra, një ekonomi ku partneriteti me sektorin privat duhet të jetë shumë më aktiv dhe konstruktiv. Paramendoni të gjitha këto mjete të ishin orientuar në projekte të ndryshme në mbështetje të sektorit privat me siguri se do të kishim një stabilitet social shumë më të madh. Do të kishim punësim, eksporte, përmirësim të imazhit dhe jo ikje nga Kosova, por qëndrim të të rinjve në Kosovë. Prandaj, tentativa për barazi në varfëri besoj është qasja më e gabuar që e dëmton Kosovën sot, por që do ta ketë efektin negativ edhe në të ardhmen. Prioritet i prioritetëve gjithmonë duhet të jetë dhe është koha kur duhet të kuptohet rëndësia e zhvillimit ekonomik, një zhvillim ekonomik i ndërtuar në partneritet të mirëfilltë dhe jo me arrogancë të pushtetit përballë sektorit privat”, ka thënë Gërxhaliu.



Lirohet nga detyra drejtori teknik në KRU “Prishtina”, Sokol Xhafa

PRISHTINË, 4 JANAR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit teknik në KRU “Prishtina”, Sokol Xhafa, është liruar nga detyra të enjten. Në vendim thuhet se Xhafa nuk ka pasur


performancë të mirë dhe si pasojë ka ngecur edhe ndërmarrja. “Vendimi është bërë pasi i njëjti nuk ka treguar performancën e pritur dhe mosveprimet e tij

kanë ndikuar që ndërmarrja të ketë edhe ngecje në sektorin të cilin e ka udhëhequr dhe në sektorët që janë atakuar nga mos puna e tij. I përmenduri

kthehet në punët dhe detyrat e mëhershme të punës - inxhinier i Hidroteknikës dhe rangohet me pagë 780.00 euro”, thuhet në vendim.



HERONJTË: 15 minuta famë



Që në lashtësi, ka patur shumë tregues të një kulture me në qendër të famshmit. Bota e lashtë greke dhe romake na ka dhënë emrat e shumë individëve që ishin të famshëm në kohën e tyre dhe karriera e të cilëve na ofron atë që e njohim sot si kulturë moderne e të famshmëve, siç janë pëlqimet, grupimet dhe të ashtuquajturat “15 minuta famë” – edhe pse pa këtë terminologji. Çmimi i famës në botën e lashtë ishte gjithashtu i ngjashëm me atë që shohim sot.

Të etur për famë: Pavdekësia përmes famës

Ndonëse jo të gjithë dëshirojnë të bëhen të famshëm, është ende një dëshirë e natyrshme njerëzore që të marrë njohje për talentet dhe kontributet e veta. Mitologjia greke ofron shumë shembuj të njerëzve që e përforcuan këtë dëshirë të thjeshtë për njohje. Në Iliadën e Homerit, Akili shpjegoi se atij iu dha zgjedhja, midis të jetuarit të një jete të gjatë por të paspikatur, ose një jete të shkurtër që do t'i jepte një shans për të arritur lavdinë dhe përjetësinë.

Akili zgjodhi opsionin e dytë – duke preferuar të jetë një temë kënge për gjithë përjetësinë. Megjithatë, një Akil më i tërhequr u rishfaq në Librin 11 të Odisesë së Homerit. Në këtë version të ngjarjeve, Odiseu lundroi drejt botës së nëndheshme dhe bisedoi me të vdekurit. Një nga këta ishte Akili. Kur u përshëndet si “i bekuar në jetë, i bekuar në vdekje”, Akili u përgjigj me hidhërim se do të preferonte të ishte skllav i zotërinjve më të ligj, sesa mbret i të gjithë të vdekurve.

Një tjetër hero, Ajaksi, thuhet se ishte çmendur kur humbi përballë Odiseut në një garë se kush ishte luftëtar më i mirë në ushtrinë greke.

Duke besuar se po hakmerrej ndaj gjykatësve, Ajaksi vazhdoi dhe theri një tufë bagëtish. Pasi erdhi në vete, heroi i poshtëruar kreu vetëvrasje duke u hedhur mbi shpatë. Drama “Ajaksi” e Sofokliut ofron një variacion të vogël të kësaj: kur Ajaksi erdhi në vete, i mbuluar me gjak, ai kuptoi se ajo që kishte bërë ia kishte ulur nderin, dhe vendosi që preferonte që më mirë të vriste veten, sesa të jetonte në turp.

Fama dhe politika, me të gjitha kurthet e saj të pasurisë, seksit

dhe pushtetit, ishin të lidhura ngushtë me Romën e vonë republikane. Jul Cezari nuk kishte turp të ishte njeriu më i pasur dhe më i pushtetshëm i brezit të tij. Me sa duket, fama dhe pasuria e tij nuk ia dëmtuan jetën seksuale, pasi Kurio Plaku e përshkroi atë si omnium mulierum virum et omnium virorum mulierem appellat (“burri i çdo gruaje dhe gruaje e çdo burri”). Perandori August, megjithatë, e ktheu magjepsjen e publikut romak me famën e tij, në avantazhin e vet politik, duke shfrytëzuar statusin e të famshmit, për të projektuar imazhin e shërbyesit publik. Fama u bë një faktor që i mundësoi të themelonte një nga qeveritë më të qëndrueshme në botën e lashtë.

15 minutat e tua të famës: Mësime nga lashtësia

Ndoshta personazhet e famshëm më të hershëm të prodhuar nga Greqia e lashtë ishin atletët. Emri i parë që hyri në rekordet historike greke të sportit është ai i një bukëpjekësi modest të quajtur Korebusi i Elisit, i kujtuar për fitimin e garës së ecjes, në festën e parë të Lojërave

Olimpike në 776 pes. Megjithëse çmimi që mori ishte një degë ulliri, nderi i fitores ishte shumë më prestigjioz. Aktivitetet sportive ishin një mënyrë efektive për të bërë publike arritjet e dikujt që më parë kishte qenë krejtësisht i panjohur për shoqërinë, pasi emri i tij do të shpallej dhe regjistrohej në të gjithë Greqinë.

Për disa, atletizmi ishte i panevojshëm. Helena e Trojës, me “fytirën e saj që lëshoi një mijë anije”, është një shembull i bukurisë që mjafton për të dhënë një famë. Në rastin e saj, burrat vinin për ta parë nga vende të largëta.

Penelopa, gruaje e Odiseut, është një shembull tjetër. Në rastin e saj, ajo kaloi 20 vjet duke pritur për kthimin e burrit, gjatë të cilëve ajo shpiku strategji të ndryshme për të vonuar martesën me një nga 108 burrat që i vardiseshin. Kurtezanja greke e shekullit të katërt para Krishtit, Phryne përdori bukurinë në profesionin e saj, ndërsa klientët e vizitonin nga e gjithë bota greke dhe e mbulonin me dhurata. Pasi u bë e pasur, Phryne ofroi të përdorte pasurinë për të rindërtuar muret rreth qytetit të Tebës që ishin shkatërruar nga Aleksandri i Madh, me kusht që muret të mbanin një mbishkrim

që promovonte bujarinë e saj. Përpyekjet e saj për vetëpromovim nuk ishin të kota, pasi retorikani Ateneus i Naucratis ka lënë shumë anekdota që lavdërojnë bukurinë dhe bujarinë e saj. Praksileti, një skulptor që u bë i dashuri i saj, thuhet se e kishte përdorur si modele për statujën e Afërditës së Knidosit – statuja e parë nudo e një gruaje nga Greqia e lashtë.

Sipas Ateneusit, Praksileti prodhoi dy statuja të tjera për Phryne: një statujë e Erosit që u shenjtërua në tempullin e Thespias dhe një statujë e vetë Phrynes, e cila ishte prej ari të dhe e shenjtëruar në tempullin e Delfit, ku qëndronte midis statujave të Arkidamit I dhe Filipit I. Kjo, natyrisht, të çon në pyetjen: çfarë bëri kurtezanja për të fituar një vend kaq të privilegjuar? Përgjigja është shumë e thjeshtë: ajo ishte e bukur dhe dinte të përfitonte prej bukurisë.

Grekët e lashtë e shihnin bukurinë si dëshmi të jashtme të hyjnisë. Ashtu si krahasimet e sotme të një aktoreje apo këngëtareje të bukur me një perëndeshë, krahasimet e një gruaje të bukur me një perëndeshë kanë qenë të njohura që nga epoka helene.



→ Çdo publicitet është publicitet i mirë? Famë me çdo kusht

Nëse dikush nuk kishte bukurinë apo aftësitë për t'u bërë i famshëm, të qenit i guximshëm ishte gjithashtu një mënyrë efektive për të arritur famën. Një shembull i kësaj përfshin një zjarrvënës të quajtur Herostrat, i cili, në vitin 348 para Krishtit, i vuri zjarrin tempullit të madh të Artemidës në Efes në Turqi, një nga shtatë mrekullitë e botës së lashtë. Herostratusi më vonë rrëfeu nën torturë, se krimi ishte nxitur nga dëshira e tij për të qenë një njeri i famshëm. Kur e dëgjuan këtë, Efesianët vendosën ta ekzekutonin dhe të ndalonin çdo përmendje të emrit të tij, duke e quajtur: “ai që nuk lejohet të përmendet”. Megjithatë, historiani i lashtë Theopompusi përmend emrin e Herostratit në librin e tij Hellenics dhe emri shfaqet përsëri më vonë në veprat e Strabonit. Fakti që ai mbahet mend edhe sot e kësaj dite dhe fakti që termi “Famë Herostratike” i referohet Herostratit, dhe do të thotë “famë e kërkuar me çdo kusht”, dëshmon se taktika e grekëve që e ekzekutuan ishte një dështim. Ashtu si sot, një mënyrë tjetër për të siguruar famën ishte punësimi i një publicisti ose një promovuesi. Nikiasi (rreth 470 pes – 413 pes), një politikan dhe gjeneral athinas në Luftën e Peloponezit, angazhoi shërbimet e një menaxheri publiciteti të quajtur Hieron për ta ndihmuar të kultivonte imazhin e një nëpunësi publik punëtor dhe vetëmohues. Sipas Plutarkut, ishte Hieroni ai që e ndihmoi Nikiasin të interpretonte këtë pjesë, duke e veshur atë me një atmosferë solemniteti dhe vetëvlerësimi.

Fama, fansat dhe grupet: Avantazhet e të qenit superstar

Garat e karrocave ishin spektakli më i vjetër dhe më

popullor i Romës së lashtë. Karroistët romakë, shumica e të cilëve ishin skllevër, mund të bëheshin të famshëm në të gjithë Perandorinë thjesht duke mbijetuar, pasi jetëgjatësia e një karrocieri ishte e ulët. Karrocieri më i famshëm nga të gjithë ishte Diokli, i cili fitoi 1,462 nga 4,257 gara. Pas një karriere 24-vjeçare, Diokli doli në pension në moshën 42-vjeçare me fitimet që thuhet se arritën 35,863,120 sesterces (15 miliardë dollarë amerikanë), duke e bërë atë yllin e sportit më të paguar në histori. Përkushtimi i tifozëve thuhet se ishte mjaft intensiv. Plini regjistron një tifoz që u hodh në pirën e funeralit të një karrocieri të njohur si Feliks. Ai shtoi se tifozët kundërshtarë u përpoqën të parandalonin që kjo histori të regjistrohej, duke pohuar se tifozit në të vërtetë i kishte rënë të fikët dhe kishte rënë pa dashje në zjarr. Për më tepër, fansat mund të angazhoheshin në këngë, aktivitete dhe tallje së bashku. Disa tifozë bëheshin problematikë për Perandorinë kur karrocieri i tyre i preferuar humbiste, pasi ata merrnin masa ekstreme dhe nxisnin trazira. Ashtu si karroistët, shumica e gladiatorëve nuk kishin zgjedhje kur hidheshin para syve të publikut. Gladiatorët tërhiqeshin kryesisht nga radhët e vrasësve dhe skllevërve të dënuar. Shumica e tyre shfaqeshin në Koloseum vetëm një herë, pasi probabiliteti që të vdisnin gjatë ndeshjes ishte goxha i lartë. Megjithatë, më i miri prej tyre arriti famë të madhe. Ishte kaq e madhe vëmendja që ata merrnin sa të tjerët, duke përfshirë gra të lira, senatorë, madje edhe perandori Komodus (161 – 192 pas Krishtit), ofruan shërbimet e tyre si gladiatorë. Gladiatorët mendohej se ishin jashtëzakonisht të fuqishëm. Poeti Juvenal e dënoi një grua të quajtur Eppia, gruaja e një senatori, e cila iku në Egjipt me një gladiator të quajtur Sergius. “Cila ishte joshja? Ai gladiator ishte i rrënuar fizikisht,” pyet

Juvenal. “Ah, por ai ishte një gladiator,” i përgjigjet Eppia. Një shkallë e caktuar e vetëvlerësimit përmes rënies në shtrat me dikë të famshëm u shfaq edhe në shfaqjen e Euripidit, Bacchae, kur Dionisi u zemërua pasi tezja e tij Agave pretendoi se nëna e tij, Semele nuk kishte fjetur kurrë me Zeusin, por se ajo flinte me një njeri të vdekshëm – duke mohuar kështu Dionisin si hyjni, dhe profilin i lartë që do të kishte përfutur, duke qenë i biri i Zeusit.

Fuqia e Famës: Si një njeri i famshëm e pa përvojë në politikë, mund të prishë një qeveri

Për pjesën më të madhe të historisë së saj, Republika Romake u qeveris nga familje të vjetra politike dhe ndërmjetës të besueshëm të pushtetit, që dinin të ndikonin dhe disiplinonin masat. Zgjedhjet u krijuan për t'i dhënë klasave në pushtet pjesën e luanit të votës popullore. Fermerët e zemëruar dhe pronarët e tavernave ndonjëherë ngriheshin dhe u bënëin presion sunduesve të tyre, për lehtësimin e borxhit dhe një zë të vërtetë në qeverisje.



Megjithatë, këto revolta shuheshin shpejt me premtimet për një të ardhme më të mirë dhe duke punësuar disa gladiatorë jashtë detyrës për të kërcënuar kryefamiljarët. Njeriu që rrëzoi këtë sistem ishte një fisnik i pasur i quajtur Publius Clodius Pulcher (rreth 93 pes – 52 pes). I mirënjohur në Romë edhe para hyrjes së tij në politikë, Clodius gjithmonë kishte tronditur dhe argëtuar publikun romak me sjelljet e tij të paparashikueshme.

Në fakt, sa më e guximshme sjellja e tij, aq më shumë publiku e donte Clodius-in. Një shembull i bëmave të Clodiusit ishte kur ai kreu sakrilegj duke u veshur si grua dhe u infiltrua në festivalin fetar vetëm për femra, për nder të perëndeshës Bona Dea, me qëllim joshjen e Pompeisë, gruas së Jul Cezarit. Skandali bëri që Cezari të divorcohej nga Pompeia. Pasi i shpëtoi dënimit përmes një ekipi të madh ligjor dhe ryshfeteve bujare, Clodiusi hyri në politikë për të siguruar pranimin dhe respektin e klasës sunduese – e cila e hodhi poshtë shpejt si një bufon. Pasi elita e kundërshtoi, Clodiusi u pozicionua si udhëheqësi i klasave të zemëruara punëtore romake. Me retorikën e tij të thjeshtë, por të zjarrtë, Clodiusi shtyu legjislacionin që krijonte dhënien e parë falas të drithit falas në historinë perëndimore; një lëvizje e cila i siguroi shumë ndjekës në mesin e njerëzve të thjeshtë, veçanërisht atyre që kishin humbur punën në trazirat e fundit ekonomike. Kjo i befasoi klasat sunduese të Romës, të cilat vazhduan të përçmojnë Clodiusin. Roma ishte kaq e ndarë gjatë fushatës së Clodiusit për pretorshipin, sa që zgjedhjet u desh të shtyreshin dy herë për shkak të luftimeve në rrugë midis ndjekësve të tij dhe fraksionit të kundërshtarit, Annii Milo. Kur Clodiusi u takua me Milon përgjatë Rrugës Apiane, shpërtheu një përleshje midis rojeve të tyre dhe Clodiusi u plagos rëndë, derisa Milo urdhëroi njerëzit e tij ta

vrinin, duke menduar se një kundërshtar popullor i vdekur ishte më pak i dëmshëm se një i gjallë dhe i zemëruar.

Dua të më lënë rehat: Ana e keqe e famës

Në filmin hollivudian të vitit 1934, “Grand Hotel”, Greta Garbo, duke luajtur personazhin e Grusinskayas, tha citimin e famshëm “Dua të më lënë rehat”, i cili u bë një nga 100 thëniet e filmave më të famshme në kinemanë amerikane. Në këtë në kohë, neveria e vetë Garbos ndaj famës ishte gjithashtu e njohur dhe MGM e kapitalizoi, duke e forcuar imazhin e saj si gruaja misterioze e heshtur dhe e izoluar.

Kjo strategji u konsiderua unike në kohën e saj dhe ndoshta një strategji e mirë për shumë njerëz të famshëm, ekspozimi i tepërt është një rrezik për të famshmit e çdo kohe. Një politikan athinas i shekullit të pestë para Krishtit i quajtur Aristides u mbiquajt gjerësisht “I drejti” për shkak të reputacionit për drejtësi dhe integritet. Një objektiv i urrejtjes për shkak të famës, ai u kërcënuar me internim për 10 vjet më vonë në karrierë.

Kjo ishte një kohë gjatë së cilës grekët do të votonin për dëbimin e politikanëve që nuk i pëlqenin, duke përdorur fletë votimi të bëra nga copa të thyera qeramike, të njohura si ostraka.

Legjenda thotë se në një kthesë të çuditshme të fatit, një fermer analfabet iu afrua Aristidesit dhe i kërkoi të gdhendte emrin “Aristides” në një rën nga këto ostraca, për të votuar në favor të ostracizmit (dëbimit) të tij.

Pa e zbuluar identitetin e vet, Aristidi e pyeti fermerin nëse politikanin në fjalë i kishte shkaktuar ndonjë lëndim personal. Fermeri u përgjigj: “Jo. Thjesht më ka ardhur në majë të hundës e jam lodhur duke dëgjuar emrin Aristid i Drejti.” (bota.al)



EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT Pilkington
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Montim
Servisim
Pergjithësi



Kampionia botërore Fabiana Bytyqi mbron titullin më 13 janar

PRISHTINË, 4 JANAR - Boksierja çeke me prejardhje nga Kosova, Fabiana Bytyqi, do të ndeshet me gjermanen Tina

Rupprecht më 13 janar në Gjermani. Kampionia e pamposhtur botërore në WBC e ka fituar

këtë titull pesë vjet më parë kur e kishte mundur britaniken Denise Castle. Bytyqi muajin e kaluar e

kishte mbrojtur titullin në një gala mbrëmje në Kosovë duke barazuar me Elizabeth Lopez Corosan e Meksikës.



Eros Grezda rikthehet në futbollin kroat

ZAGREB, 4 JANAR - Futbollisti Eros Grezda, i cili deri vonë ishte pjesë e kombëtares shqiptare, ka gjetur një sfidë të re në karrierën e tij, duke u bërë pjesë e skuadrës kroate Rudesh. Prezantimi zyrtar është bërë të mërkurën, duke shënuar një kapitull të ri në karrierën e tij, pasi ka lënë Partizanin e Tiranës, ekipin ku ai nuk ka arritur të impresionojë me paraqitjet e tij. Grezda, i njohur për aftësitë e tij si sulmues krahu, ka përvojë të pasur në kampionatin kroat. Me 108 paraqitje për ekipet si Osijek, Lokomotiva, dhe Shibenik, ai ka lënë një ndikim të qëndrueshëm në skenën e futbollit të Kroacisë. Megjithatë, ka të dhëna që tregojnë se karriera e tij ka pësuar një rënie, duke u bashkuar me Rudeshin, ekipin që aktualisht mbart barrën e fundit në kampionatin kroat, me vetëm katër pikë të fituara nga 19 ndeshje. Sfida për të ndikuar në performancën e ekipit dhe rikthimi i tij në formën e mëparshme do të jetë një nga provat e vështira që Grezda do të përballlet në këtë kapitull të ri të karrierës së tij futbollistike.



Mourinho refuzon Brazilin



ROMË, 4 JANAR - Federata Braziliene e Futbollit është në kërkim të një selektori pasi ka dështuar ta bindë Carlo Ancelottin për ta marrë në dorë kombëtaren braziliene. Sipas medieve jug-amerikane, brazilianët tash ia kanë mësyre trajnerit të Romës, Jose Mourinho. Por, portugezi nuk

duket shumë i interesuar për ta marrë në dorë “Seleção”. Ai është i fokusuar totalisht tek ekipi që e drejton aktualisht. “Brazili nuk më ka thirrur për t’u bërë trajner i tij i ri. I kam thënë menaxherit tim: mos fol me askënd derisa të jem trajner i Romës. Unë u besoj 100 për qind pronarëve të Romës.

Gjithmonë i kam informuar ata, përfshirë këtu edhe kur Portugalia më thirri... Edhe kur klubet nga Arabia Saudite më thirrën verën e kaluar”, ka deklaruar fillimisht “Special One”. Ai është i vendosur të arrijë suksese të reja me Romën dhe të vazhdojë të punojë në Serinë A.

PSG-ja fiton Superkupën e Francës

Paris Saint-Germain (PSG) e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme vitin 2024, duke fituar Superkupën e Francës pasi ka mposhtur Toulousen në finale. “Parisienët” kanë shkëlqyer me një paraqitje fantastike për të fituar në fund me rezultat komod 2:0. Pas vetëm tre minutave lojë, Kang-In

Lee ka kaluar PSG-në në epërsi pas një asistimi të shkëlqyer të Ousmane Dembeles. Toulouse kishte raste ta barazonte rezultatin përmes Suazo dhe Dalling, por të dytë kanë dështuar nga afërsia. Ishte Kylian Mbappe që ka dyfishuar epërsinë me një eurogol në minutën e 44-t.

Pjesa e dytë ishte shumë më e qetë, ku dy skuadrat kishin disa raste shënimi, por larg finalizimit. Kësisoj PSG e ka ruajtur rezultatin deri në fund, duke e siguruar trofeun e parë për vitin 2024. Ndërkohë, klubi francez mbetet në garë edhe për trofe të tjerë, si Liga e Kampionëve dhe Liga 1.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Rent A Car Nokaj” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812063270 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rent A Car Nokaj” D.O.O. Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812063270 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Rent A Car Nokaj” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 812063270 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Njoftim për shuarje të biznesit “Noja Kuzhinë”, Sh.P.K

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Noja Kuzhinë”, Sh.P.K, me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811498254 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Noja Kuzhinë”, d.o.o., od Prizren, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811498254 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Noja Kuzhinë”, L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811498254, from Prizren, has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Prite N’shpi” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812014869 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE


Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Prite N’shpi” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812014869 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Prite N’shpi” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812014869 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Endrit Cakolli shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Learta Jusufaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.
- Arben Milici shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10, 11, 12 të shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.
- “Market Rroni 2”, SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër: 810873572.
- “Free Shop Rroni” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 810868664.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Zveçanit
Opština Zvečan – Municipality of Zvečan

Drejtoria e Arsimit
Dt.05.01.2024
Nr. 32 / 2024

Në bazë të nenit 77 pika 1 e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtaret publikë të Republikës së Kosovës, të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të punës nr. 03/L-212, nenit 4 dhe 5, të udhëzimit administrativ ne. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtoria e Arsimit shpallë;

KONKURS
(rishpallje)

Titulli i vendit të punës; Sekretar/e

- Sekretar/e në SHFMU “Isa Boletini”- Boletin

Institucioni;	Komuna Zvečan
Departamenti/ Drejtoria;	Drejtoria për Arsim
Lloji i pozites;	Me afat të pacaktuar, me orar të plotë
Numri i pozitave;	Një(1)
Titulli i mbikëqyrësit;	Drejtori i shkollës

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Harton planet e punes në pajtim me mbikqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të shkolles dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e tyre.
2. Mban evidenca të kërkesave dhe ankesave të mundshme, mban dosje dhe arkivim të tyre
3. Përditëson dosjet e personelit të shkollës me dokumente dhe të dhëna duke u kujdesur për procedurat ligjore
4. Përgatitë dokumentacionin pedagogjik të shkollës
5. Mer pjesë në grupet punuese në fushen profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
6. Bë hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikqyrësi
7. Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi i tij.

Kushtet e përgjithshme dhe të veqanta për vendin e punës

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë zotësi veprimi;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për gjuhët
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formes së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje

Shkollimi i kërkuar;

- Diplomë universitare

(Në mungesë të kandidatëve adekuat/ me kualifikim të përafërt)

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera;

- Njohuri në fushen profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel...)

Dokumentet e nevojshme;

- Diploma mbi kualifikim universitar
- Diplomat e lëshuara nga Institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje)
- Qertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dokument identifikimi(kopje)

Dokumentet e pranuar nuk i kthehen kandidatëve’

Informatë e përgjithshme;

Aplikacionet merren dhe dorëzohen pranë zyres së komuniteteve në fsh. Lipë/ Komuna Zvečan. Afati për aplikim është 8 dite nga data e shpalljes publike të konkursit. Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.

Drejtoria komunale e arsimit
Komuna Zvečan



